



NJË VIT PAAFTËSI

DËSHTIMET E MËDHA TË QEVERISË

NJË VIT PAAFTËSI

Më 22 mars 2022, bëhet një vit i qeverisjes Kurti. Përgjatë 12 muajve, kjo qeverisje është përcjellë me popullizëm, arrogancë numrash, arsyetime tek e shkuara e mungesë të qartë të vizionit zhvillimor për Kosovën. Është përcjellë edhe me braktisje të kauzave fundamentale të ngritjes në pushtet; siç është braktisja e halleve dhe nevojave të qytetarëve në secilën krizë me të cilën janë ballafaquar për një vit.

Nga kriza e pandemisë, ajo e energjetikës e deri tek rritja alarmante e çmimeve – Qeveria Kurti ka vendosur t'i braktisë qytetarët tanë, dhe në betejën e tyre me përballueshmërinë, të sillet si vështuese e krizave. Ajo ka dështuar të reagojë me kohë; siç ka refuzuar të ndërmarrë masa adekuate që do të zbusnin secilën krizë.

Kjo qeveri, në paaftësinë e saj vepruese për qytetarë, megjithatë ka qenë e aftë të kapë borde, kompani publike e institucione të pavarura me të afërm e familjarë. Kapja e këtyre institucioneve jetike për funksionalizimin e shëndoshë të shoqërisë, ka rezultuar të jetë fatale në secilin ballafaqim me krizë.

Në politikë të jashtme, kjo qeveri është karakterizuar nga skandale me dëme të pa riparueshme për pozitën e vendit – me komunikime amatoreske dhe diskurs jo adekuat diplomatik. Mbi të gjitha, është karakterizuar me mungesë të takimeve të rëndësishme në nivel ndërkombëtar; përjashtoj takimet e forumeve të përbashkëta me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Izolimi i Kosovës po merr formë çdo ditë; dhe në rrethanat e reja gjeopolitike, mosaktivizimi i Qeverisë tonë është humbje e jashtëzakonshme e mundësisë.

Në dialog, kjo qeveri ka treguar mospërgatitje të plotë profesionale e të përkushtimit. Përtej ndryshim-qëndrimeve themeltare të saj, ajo ka kaluar nga mosprioritizimi i dialogut si orientim, drejt e në transformimin teknik të tij; duke vendosur në rend të dytë kështu nevojën për marrëveshje përfundimtare drejt njohjes reciproke e hapjes së dyerve të Kosovës në integrimet euroatlantike.

Në politikën e brendshme, Qeveria Kurti ka qenë sa arrogante aq edhe konfliktuoze. Në secilën përfshirje të saj, në drejtësi, sindikata, trupa të pavarur e me vet spektrin politik në vend, kjo qeveri ka dështuar të sigurojë konsensusin minimal për një demokraci të shëndoshë e prosperuese. Tendencat e saj kontrolluese prej pushtetit absolutist, janë përcjellë me sulme edhe ndaj medieve e ndaj fjalës së lirë.

Dëshpërimi qytetarë me një qeverisje të tillë, përtej zërit votues në zgjedhjet lokale të 17 tetorit e 14 nëntorit, është përcjellë edhe me largim masiv të qytetarëve tanë, të të rinjve e të rejave, profesionistëve e punëtorëve nga Kosova. Rreth 55% e qytetarëve tanë, konsiderojnë largimin nga Kosova; dhe ky fakt duhet të na shqetësojë të gjithëve.

Në vijim, janë dështimet e mëdha të Qeverisë Kurti në 12 muaj qeverisje.

1. REFUZIMI I GAZIFIKIMIT TË KOSOVËS

Qeveria e Kosovës një vit qeverisje nuk ka shpalosur asnjë projekt konkret për rritjen e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike. Gjendja energjetike në Kosovë aktualisht është e paplanifikuar, e pamanaxhuar, me kosto të lartë për qytetarët dhe bizneset dhe pa të ardhme të sigurt të furnizimit me energji elektrike për nevojat momentale, ndërsa për nevojat e ardhshme të një ekonomie më të zhvilluar kosovare, as që mund të bëhet fjalë.

Në këtë fushë, refuzimi i gazifikimit të Kosovës, nëpërmjet fondeve të garantuara të MCC-së e SHBA-së (rreth 200 milionë dollarë), përveç se gabim strategjik i interesave nacionale të Kosovës, është edhe dëm i pariparueshëm energjetik për vendin tonë. Kosova po futet në vitin e dytë të qeverisjes, pa qartësi energjetike rreth projektit në fjalë; dhe me vullnetin politik të deklaruar tashmë, refuzues ndaj një lidhje të tillë.

Orientimi i gabuar strategjik i Qeverisë së Kosovës, përveç se ka shkaktuar humbje të paarsyeshme të 200 milionë eurove të dedikuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka izoluar Kosovën, si shtetin e vetëm në Ballkanin Perëndimor, pa ambicie e pa ide për qasje në rrjetin e gazit amerikan.

“

Refuzimi i projektit strategjik të gazit ia humb Kosovës 200 milionë dollarë të garantuara nga ShBA.

”

2. KRIZA ENERGETIKE

Përkundër paralajmërimeve se çmimet e energjisë elektrike do të rriteshin gjatë dimrit 2021-22, si rezultat i hovit ekonomik postpandemik, Qeveria e Kosovës ishte e fundit në reagueshmëri. Përderisa Qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian kishin nisur planifikimet për përballje në korrik të vitit 2021, e vendet e rajonit në tetor të vitit 2021; Qeveria e Kosovës gjendjen emergjente e kishte shpallur tek më 28 dhjetor të vitit 2021, pas muajsh mohimi se në Kosovë ka krizë. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës kishte dështuar të nënshkruaj ndonjë kontratë afatgjate për furnizim me energji elektrike; nuk kishte planifikuar asnjë riparim me kohë të kapaciteteve gjeneruese në KEK, e nuk kishte ndërmarrë asnjë masë reagueshmërie ndaj tërheqjeve të vazhdueshme të energjisë elektrike nga KOSTT-i për plot 45 ditë.

“

Rritje e faturave të energjisë
deri në **80%**

”

Në janar të vitit 2022, si rezultat i vonesës në reagueshmëri, Qeveria e Kosovës, nëpërmjet ZRRE, kishte ofruar një propozim për rritje drastike të çmimeve; të paprecedente në historinë e Kosovës. Këto propozime nuk morën për bazë as rekomandimet e palëve të tjera e edhe më pak shembujt e shumë shteteve të Bashkimit Evropian, që për bazë kishin përballueshmërinë e qytetarëve. Propozimi i sponsorizuar i Qeverisë ishte diskriminues, i palogjikshëm në ndarje të tarifave dhe i papërballëshueshëm për shumicën e familjeve kosovare. Kështu, çmimet e energjisë elektrike u rritën nga 29%, 49%, 59% për shpenzuesit e 1200 kWh, 1800 kWh e 2400 kWh respektivisht.

Përtej këtyre rritjeve, Qeveria dha edhe plot 141 milionë euro të tjera; përkatësisht, 11 milionë ju ndanë KOSTT-it për shpenzimet në Veri; 20 milionë tjera KOSTT-it në formën e dividendës së papaguar; 20 milionë euro subvencione për importimin e energjisë elektrike; 90 milionë euro subvencione për faturat e energjisë elektrike.

3. KRIZA E ÇMIMEVE

“

Rritje enorme e çmimeve të produkteve esenciale”

Papërbalueshmëria qytetare në Kosovë është goditur edhe nga inflacioni rekord i muajve të parë të vitit 2022. Sipas raporteve të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni në muajin shkurt është rreth 7.5%; me një numër të konsiderueshëm të produkteve bazike të shportës së konsumatorit në rritje të mbi 50% të çmimeve. Një ndër produktet me rritjen më të lartë është ai i derivateve, të cilët, në kthim, kanë shkaktuar rritjen e çmimeve të mbi 130 produkteve tjera në Kosovë. Kështu, çmimi i domateve është rritur për 65%; i vajit për 42%, i miellit për 33%, i patateve për 22%, i bukës për 20%, i druve për 16% e i vezëve e qumështit për 15% respektivisht 10%.

Ndonëse një pjesë e madhe e inflacionit është e importuar në Kosovë, si rezultat i bilancit të pafavorshëm tregtar të Kosovës – i cili, gjatë vitit të shkuar është thelluar edhe më shumë – Qeveria e Kosovës ka vendosur të vëzhgojë gjithë këtë krizë dhe të refuzojë të ndërmarrë hapa konkret fiskal në zbutjen e përbalueshmërisë.

Përderisa të gjitha vendet e rajonit – dhe jo vetëm – kanë modifikuar politikat e tyre fiskale për periudhën afatshkurtër, dhe përkundër rekomandimeve konkrete të LDK-së, opozitës, shoqërisë civile e palëve të tjera, Qeveria e Kosovës ka refuzuar secilën masë në këtë drejtim. Në vend të shfrytëzimit të instrumenteve në dispozicion të Qeverisë, ajo ka vendosur që betejën kundër inflacionit ta zëvendësojë me betejë kundër evazionit fiskal, duke përdorur policinë e intervenimet ad hock mbi marginalitetin e profitit – intervenime tërësisht kundërkushtetuese.

Mbi të gjitha, Qeveria e Kosovës ka refuzuar të ndërmarrë hapa me kohë, të paralajmëruar, në adresimin e krizave të ardhshme furnizuese – në theks të veçantë para shpërthimit të luftës në Ukrainë; siç dhe ka refuzuar të adresojë me kohë

kërkesat për funksionalizim të institucioneve që do të trajtonin keqpërdorimet spekulative me çmime në kohë të krizave veçse të paralajmëruar a- siç është rasti i funksionimit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

4. POLITIKA E JASHTME E IZOLUAR

Politika e jashtme është dështimi kryesor i kësaj qeverie. Ajo është karakterizuar nga skandale me dëme të pa riparueshme për pozitën e vendit, me komunikime të turpshme e amatoreske dhe diskurs jo adekuat diplomatik. Mbi të gjitha, është karakterizuar me mungesë të takimeve të rëndësishme në nivel ndërkombëtar – përjashto takimet e forumeve të përbashkëta me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Qeveria e Kurti ka dështuar në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, duke mos arritur t'i forcojë marrëdhëniet bilaterale me shtetet mike në nivele të larta përfaqësimi; duke mos prosperuar në procesin e anëtarësimit, organizata ndërkombëtare dhe duke mos arritur përfaqësimin adekuat në iniciativat rajonale.

Në forume ndërkombëtare Qeveria Kurti ka bërë shpërfillje totale të interesave shtetërore duke i dhënë përparësi diskursit politik partiak në takime ndërkombëtare. Ky diskurs partiak, që ka zëvendësuar atë shtetëror, ka shkaktuar refuzim të komunitetit ndërkombëtar për të trajtuar seriozisht shtetin e Kosovës.

Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të prezantojë një vizion e strategji për politikën e jashtme e cila do të parashihte reformën e premtuar në shërbimit diplomatik. MPJ ka përligjur kundërligjshëm gradat e dhëna dhe ka dhënë grada diplomatike pa u bazuar në meritë. Në ndërkohë, e njëjta ka shkarkuar 12 ambasadorë duke e lënë Kosovën të pa përfaqësuar për më shumë se gjashtë muaj në gjysmën e shteteve ku ka ambasada Kosova. Ky proces përveç i dëmshëm për marrëdhëniet bilaterale me shtetet mike, u përcjell me shkelje të rënda ligjore.

Qeveria e Kosovës ka dështuar të shfrytëzojë momentumin e ri të krijuar në Perëndim, në fushën e diplomacisë e të sigurisë, pas intervenimit rus në Ukrainë. Në theks të veçantë, është dështimi spektakular i përfaqësuesve tanë në Këshillin e Evropës. Pas përjashtimit të Rusisë nga ky Këshill, në kohën kur bëheshin thirrje ndërkombëtare për praninë të Kosovës aty, zëvendëskryeministri i Kosovës Bislimi prodhon një skandal turpëruës ndërkombëtar duke i humbur kredibilitetin dhe seriozitetin institucioneve tona.

Përgjatë një viti qeverisjeje, Qeveria Kurti nuk ka siguruar as edhe një njohje të vetme. Ajo nuk ka paraqitur asnjë strategji komunikimi me 5 vendet mosnjohëse dhe nuk ka arritur të dëshmojë veprime konkrete për lobim e promovim diplomatik, kulturor dhe ekonomik. Idetë elektorale të kësaj Qeverie, sikurse zëvendësimi i CEFTA-s, janë shpërfillur e injoruar nga BE.

“

Politika e jashtme me skandale të pariparueshme diplomatike

”

Mungesa e vizitës së kryeministrit të Kosovës në Washington, është sinjali më i rëndë shqetësues për Kosovën dhe aspiratat tona nacionale për integrim euroatlantik e për partneritet të përhershëm me SHBA-në.

Në vend të thellimit të marrëdhënieve me shtetet fqinje, zbeheje të relacioneve – sidomos me Republikën e Shqipërisë. Janë shënuar raporte rutinore pa zbatuar asnjë veprim konkret të dalë nga marrëveshjet e nënshkruara në mes të kryeministrave. Ilustrative është shkëmbimi i punëtorëve dhe mallrave.

5. KTHIM NË DIALOG TEKNIK

Qeveria e Kosovës ka treguar mungesë fokusi në dialogun e ndërmjetësuar nga BE dhe SHBA; fillimisht duke e prioritzuar si temë triviale e më pas duke marrë pjesë në këtë proces pa agjendë dhe pa platformë dialoguese. Kalimi nga refuzimi në pjesëmarrje të papërgatitur dhe pa strategji nuk i sjellë dhe nuk i ka sjellë Kosovës asnjë rezultat politik ndërkombëtar.

“

Kalimi i dialogut nga politik në atë teknik - dëmi më i madh politik i shkaktuar në vend”

Kjo qasje, në jo pak qarqe ndërkombëtare, ka arritur të portretizojë Serbinë si palë konstruktive; ndonëse e njëjta as nuk ka vullnet e as dëshirë të arrijë marrëveshjen përfundimtare rreth njohjes reciproke mes dy shteteve.

Dëmi më i madh politik i shkaktuar për interesat e Kosovës është kalimi i këtij dialogu në nivel tërësisht teknik; duke zëvendësuar kështu përkushtimin e madh të aleatëve tanë për një marrëveshje përfundimtare që në fokus ka njohjen reciproke, në respektim të plotë të integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Kosovës. Në këtë drejtim, përfshirja e Qeverisë së Serbisë në tërheqjen e njëjësive policore nga territori i Kosovës është dëmi më i madh politik i shkaktuar në vitet e fundit dialoguese.

Kosova vazhdon të humbasë momentume të rëndësishme politike; ndër të cilat edhe momentumin e prezencës së Administratës Biden dhe fokusit të dhënë në integrimin euroatlantik të Republikës së Kosovës.

Procesi i dialogut, në këtë periudhë, është konkretizuar edhe me mungesë të plotë të transparencës dhe komunikimit ndër politik shqiptar në Kosovë.

6. JOEFIKASITETI I KUVENDIT

Në Programin legjislativ për vitin 2021, Qeveria e Kosovës kishte paraparë të kalojë 186 projektligje. Në vitin e parë kalendarik të kësaj shumice, pra deri më 31 dhjetor të vitit 2021, janë aprovuar vetëm 36 ligje; përkatësisht, vetëm 19% e agjendës legjislative është e përbushur në këtë fillimvit.

Pushteti i Lëvizjes Vetëvendosje mbanë shumicën parlamentare e pa shqetësuar nga koalicionet eventuale. Përkundër kësaj, deputetët e shumicës nuk kanë arritur të kalojnë as një të pestën e ligjeve të sjella në Kuvend. Të njëjtit, ndërsa, ndonëse kanë arritur të miratojnë vetëm 36 nga 186 ligje, janë paguar në plotni për punën e tyre.

Ky dështim parlamentar i shumicës, është i paprecedentë në historinë e Kosovës, dhe i njëjti dëshmon për paaftësinë udhëheqëse të partisë në pushtet, e cila sa herë ballafaqohet me obligime e detyra konkrete, nuk dështon të dëshpërojë skajshmërisht.

“

Shumica parlamentare prej 50.2% realizon vetëm 19% agjendën legjislative

”

7. KAPJA E BORDEVE DHE AKTAKUZAT E PUSHTETARËVE

“

Kapja e institucioneve të pavarura nga pushteti

”

Depolitizimi i bordeve të ndërmarrjeve publike dhe çlirimi i tyre nga nepotizmi (punësimet familjare të pushtetarëve), është një nga çështjet jetike për zhvillim normal të ndërmarrjeve publike të Kosovës që më pas këto ndërmarrje të mund të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët e Kosovës.

Në muajt e parë të qeverisjes, Lëvizja Vetëvendosje emëroi militantët e vet partiak, pavarësisht mungesës së kualifikimit të tyre profesional, në të gjitha Bordet e Ndërmarrjeve Publike në vend; me theks të veçantë ato në KEK, PTK, Trepçë e Ujësjiellës (të gjithë pa dallim). Një pjesë e këtyre emërimeve ishin anëtarë të familjeve të ngushta të zyrtarëve të pushtetit. Lëvizja Vetëvendosje organizojë dhe implementojë edhe kapjen e institucioneve të pavarura në Kosovë në rregullatorë, inspektorate e trupa tjerë mbikëqyrës.

Përtej kapjes së drejtpërdrejtë të trupave të definuar si të pavarur, Qeveria Kurti është karakterizuar edhe me ministra e zyrtarë të lartë nën aktakuzë. Kështu, sot, 3 nga 16 ministrat aktual të Qeverisë Kurti, kanë aktakuzë – një rast i paprecedent në shumë vende demokratike. Dorëheqja e ministrave në kohën e vërtetësisë së fajësisë së tyre është akt minimal demokratik.

8. MOSFUNKCIONALIZIMI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

Për vetëm një vit qeverisje, Qeveria Kurti ka arritur të defunksionalizojë një pjesë jetike të institucioneve të pavarura, që kanë impakt të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër to, më të rëndësishmet janë Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP); Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK); si dhe Bordi i Ankesave të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM).

Ndonëse ky pushtet ka mbi 50% të votave të nevojshme parlamentare për zgjedhjen e trupave që do t'i rifunksionalizonin organet në fjalë, me vetëdije ka zgjedhur t'i lë të paralizuara ato. Ndër të tjerash, mosfunksionalizimi i Bordit të OSHP-së, që në rend mbanë mbi 600 ankesa, i ka paralizuar dhe investimet kapitale në vlerë prej 500 milionë eurove.

Një ndër dështimet më të mëdha të shumicës është edhe moszgjedhja e dy kandidatëve të Gjykatës Kushtetuese. Duke refuzuar konsensusin dhe diskutimin politik me partitë parlamentare, Qeveria e Kosovës dhe shumica e Lëvizjes Vetëvendosje, qëllimshëm prodhon institucione të paaftha për të ushtruar funksionin e tyre publik.

“

Mosfunksionalizimi i Bordit të OSHP-së **paralizon investimet kapitale në vlerë prej 500 milionë eurove**

”

9. VETINGU POLITIK

Menaxhimi i dështuar politik i një ndër proceseve më të rëndësishme të drejtësisë kosovare, ai i vetingut, ka vendosur gjithë procesin në vijë të dështimit të plotë. Ministria e Drejtësisë, si bartëse e këtij procesi, ka shkaktuar polarizim të skajshëm në raportet Qeveri - Këshill Gjyqësor të Kosovës dhe Këshill Prokurorial të Kosovës, si dhe ka nxitur akuza dhe kundër akuza ndërmjet tyre, fakt ky që ka shkaktuar humbjen e besimit qytetar lidhur me një proces të pavarur, të paanshëm dhe të drejtë të vetingut që mund ta kryejë Ministria e Drejtësisë. I detë e Qeverisë Kurti janë të orientuara drejt kapjes së institucioneve të drejtësisë, dhe me këtë të shtrirjes së kontrollit të plotë në të gjitha sferat e jetës.

Qeveria Kurti nuk ka arritur të bindë as partnerët ndërkombëtarë se kjo Qeveri ka kapacitete, ka vullnet dhe mbi të gjitha ka ide se mund të zhvillojë pastër dhe me kredibilitet këtë proces. Në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovë, të vitit 2021, lidhur me nismën e Qeverisë Kurti për veting të tërësishëm të sistemit të drejtësisë thuhet: "ndërmarrja e një ri-vlerësimi të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve është brengosëse dhe paraqet një burim shqetësimi serioz".

Komunikimi me partitë opozitare, për një proces që domosdo kërkon ndryshime kushtetuese dhe rrjedhimisht konsensus politik kosovar, është inekzistent. Meqë është i tillë, e vendosë gjithë procesin e vetingut në buzë të kolapsit ende pa nisur mirë.

“

VETINGU tendencë për përdorim të brendshëm politik

”

10. PANDEMIA

Menaxhimi pandemik i Kosovës është shënuar në faza me numrin më të lartë të infektiveve për ditë dhe numrin më të lartë të vdekjeve për kokë banori – krahasuar me të gjitha vendet e Evropës. Gjatë mandatit një vjeçar të kësaj Qeverie, mbi 1300 qytetarë të Kosovës kanë humbur jetën; ndërkaq vetëm në shtator të vitit 2021, kanë humbur jetën 450 prej tyre. Në të njëjtën kohë janë shënuar mbi 140 mijë raste të infektuar me Covid-19.

Aplikimi i masave pa koordinim me grupe te interesit dhe komuna ka ndikuar në rritjen e vdekshmërisë gjatë muajve gusht - shtator 2021.

Në periudhë të vdekjeve të larta, mbylljes ekonomike e paaftësisë implementuese të vendimeve të ndërmarra, Qeveria e Kosovës kishte asgjësuar mbi 133,000 vaksina – si pasojë e mospërdorimit të tyre.

Kriza e pandemisë ishte përcjellë me menaxhim të dobët e shpeshherë dhe skandaloz të kapaciteteve humane e fizike në sektorin e shëndetësisë. Vetëm në kohë të pandemisë, gjatë vitit të shkuar, mbi 500 pjesëtarë të personelit shëndetësor ishin larguar nga puna. Të njëjtit ishin të përgatitur dhe me eksperiencë për ballafaqim me COVID-19. Po në këtë periudhë, Qeveria Kurti kishte zvogëluar shtesat prej 250 eurove për personelin shëndetësor.

Në këtë periudhë, Qeveria e Kosovës ka dështuar plotësisht të implementojë masat e kontrollit në vend, duke lejuar grumbullimin e masave dhe shpërndarjen e virusit gjatë gjithë vitit. Masat shabllone, të kufizimeve në orar, pa ndonjë matje e analizë në rezultat të tyre, ishin tipike për këtë Qeveri

Gjendja në sektorin shëndetësor vazhdon të jetë e rënduar. Vetëm në vitin 2021, 159 mjek e kanë lëshuar Kosovën, ndërsa këtë vit vetëm për 1 muaj edhe 45 mjek të tjerë kanë ikur nga vendi. Ngecjet në plotësim-ndryshim të statutit të SHSKUK si dhe mosavancimi në procesin e plotësim-ndryshimit të ligjit për shëndetësi, po e thellojnë dështimin e kësaj qeverie të paaftë. Deri më tani, asnjë hap nuk është ndërmarrë në themelimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore; e spitalet e Kosovës vazhdojnë të mbesin me mungesë të theksuar të barnave nga lista eseniale.

“

Nga paaftësia shënohen rekorde të zeza

”

11. STAGNIMI EKONOMIK

Për një vit të plotë qeverisjeje, Qeveria Kurti nuk ka arritur as të portretizojë e edhe më pak të nisë edhe një projekt të vetëm madhor kapital. Mungesa e projekteve kapitale, të përmasave transformuese, nuk është e paraparë as në Buxhetin e vitit 2022 e as në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Kjo mungesë shpërfaqë më së miri mungesën e ambicies dhe vizionit që kjo Qeveri ka për Kosovën. Ajo mjaftohet me shpërdorime shifrash, e akte ekonomike simbolike, për të pasqyruar një zhvillim “të pashembullt ekonomik’.

Mungesën e projekteve kjo Qeveri ka provuar ta zëvendësoj me numra fiktiv, kryesisht duke krahasuar zgjerimin ekonomik postpandemik me vitin 2020; vitin e mbylljes së plotë ekonomike e shoqërore të Kosovës.

Përgjatë vitit të shkuar, Kosova ka vazhduar të shënojë rritje alarmante të importeve, të cilat, përherë të parë në historinë e Kosovës, arrijnë shumën prej 4.7 miliardë eurosh në vit. Së këndejmi, është rritur edhe deficitit tregtar, i cili ka arritur rreth 4 miliardë euro.

Ndonëse kjo shumicë e tanishme e kishte si kauzë të përhershme barazinë tregtare me Serbinë, vetëm gjatë vitit të parë të qeverisjes së tyre, importet nga Serbia janë rritur nga 174 milion euro që ishin në vitin 2020, në 305 milion euro në vitin 2021.

“

Qeveria i braktisë qytetarët, ndërsa qytetarët e braktisin vendin!

”

Përtej rritjes së kostos së jetesës, me tregues alarmant të inflacionit që afrohen në numra dyshifror këtë vit; në mungesë të masave efektive të Qeverisë që zbusin përbalueshmërinë; në mungesë të investimeve të mëdha kapitale që transformojnë vendin tonë, ky vit qeverisës është karakterizuar me shkurtime të investimeve kapitale në nivel lokal – si rrjedhojë e hakmarrjes politike të pushtetit ndaj komunave të humbura nga ta.

Qeveria e Kosovës – si me çdo temë tjetër ku është përfshirë – ka dështuar të ndërtojë edhe konsensusin social rreth pagës minimale në vend.

Aty ku duhej bashkëpunim, kjo qeveri ka krijuar konflikte me sindikata e grupe të interesit; duke sulmuar shpesh dhe pavarësinë funksionuese të tyre.

Vonesat tjera në shpërndarjen e subvencioneve, me theks të veçantë në bujqësi, kanë dëmtuar rëndë bujkun kosovar dhe nivelin e prodhimit në vend.

Ky stagnim shoqëror e ekonomik, i përcjellë me dëshpërimin politik, ka prodhuar një gjendje të re të ikjes masive nga Kosova. Matjet e opinionëve publike në vend japin shifra alarmante sa i përket gatishmërisë së qytetarëve tanë për të ikur nga Kosova. Në matjet e muajve të parë të vitit 2022, rezultoi që mbi gjysma e qytetarëve kosovarë, konsiderojnë largimin nga vendi. Vetëm në muajt dhjetor 2021 dhe janar 2022, në ambasadën gjermane në Prishtinë, kanë aplikuar për vizë pune mbi 105.000 qytetarë. Interesim të madh për viza pune ka edhe në ambasadat e vendeve të tjera.

Ky numër alarmant është refleksion i dëshpërimit kolektiv me gjendjen e tanishme politike, ekonomike, shoqërore në Kosovë – gjendje e ushqyer në vazhdimësi nga një qeverisje arrogante dhe braktisëse e nevojave të qytetarëve tanë.

12. SULMI NDAJ MEDIEVE DHE JOTRANSPARENCA

Qeveria Kurti ka zgjedhur që në vend të informimit të opinionit publik përmes medieeve, të filloj një luftë të ashpër kundrejt tyre. Kjo e paparë më herët në vendin tonë, ndërsa praktikë e njohur për vendet me demokraci të brishta.

Qeveria, luftën e saj me medie, e ka zhvilluar në të gjitha frontet, e me të gjitha mjetet, madje pa kursyer edhe seancën solemne të 17 shkurtit, nga ku mediet i ka akuzuar si të lidhura me agjenda dashakeqëse për vendin tonë.

Gazetarët dhe mediumet në Kosovë përballen me probleme të mëdha. Kërcënimet, shantazhet e madje edhe sulmet fizike janë bërë përditshmëri për punën e tyre. Fatkeqësisht e gjithë kjo klimë është ushqyer vazhdimisht nga Qeveria Kurti.

Rrjedhimisht, me këtë qasje ndaj medias, qeveria Kurti karakterizohet edhe me mungesë të transparencës. Çështjet me interes të lartë publik kanë qenë të mbyllura hermetikisht për publikun. Pa e përjashtuar edhe mungesën e Raportimit në Kuvendin e Kosovës mbi çështjet e rëndësishme, përfshirë këtu edhe dialogun.

Numri tejet i vogël i konferencave për medie nga kryeministri dhe kabineti i tij qeveritar janë faktorë tjetër i mungesës së transparencës. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me numrin e vogël të konferencave për shtyp, e mosgatishmërinë e Qeverisë që t'iu përgjigjet pyetjeve të gazetarëve, e të cilat janë me interes për publikun.

“
**Sulmi ndaj mediave si
mjet komunikimi!**
”